



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria –Vlada-Government*



*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit / Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Inovacije / Ministry of Education, Science and Innovation*

Kabineti i Ministrimit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Numër: 01 + 028  
Datë: 11.04.2025

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të neneve 8, 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare nr. 7/01 mars 2019), nënparagrafit 1.5 i paragrafit 1 të nenit 11 të Ligjit Nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (G.Z. e Republikës së Kosovës/Nr. 34/18 nëntor 2022, Prishtinë) dhe udhëzimin administrativ 136/2020, për krijimin e strukturës stimuluese për mbështetjen e shkollimit të nxënësve në drejtimet deficitare dhe për vajzat/gratë në Drejtimet teknike në institucionet e arsimit dhe aftësisimit profesional (IAAP), nxjerr:

#### V E N D I M

#### **Për ndarje të bursave për nxënës në drejtimet deficitare dhe për vajza në drejtimet teknike në Institucionet e Arsimit dhe Aftësisimit Profesional (IAAP)**

1. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) për vitin e ri shkollor 2025-2026 ndan bursa për nxënësit e IAAP-ve për klasën e 10-të.
2. Vlera e bursës për nxënës është 50 (pesëdhjetë) euro në muaj (përveç muajt korrik dhe gusht), përkatësisht 500 (pesëqind) euro për një vit shkollor.
3. Numri i bursave është 100, në drejtimet deficitare 70 dhe për vajza në drejtimet teknike 30.
4. Në drejtimet deficitare mund të aplikojnë të gjithë nxënësit e IAAP-ve ndërsa, për drejtimet teknike vetëm vajzat.
5. Bursat ndahen për tri vite të shkollimit në IAAP siç është përcaktuar me UA.
6. Bursa për drejtimet deficitare:
  - 6.1. Zhvillues i aplikacioneve softuerike;
  - 6.2. Teknik i sistemeve solare fotovoltaike;
  - 6.3. Pylltari;
  - 6.4. Agrobiznes;
  - 6.5. Automekanik;
  - 6.6. Asistent i turizmit dhe udhëtimeve;
  - 6.7. Përpunimi i drurit/Zdrukthëtar;

7. Bursat për vajza në drejtimet teknike:
  - 7.1. Instalues elektrik;
  - 7.2. Instalues i ngrohjes, klimatizimit dhe ujësjellësit;
  - 7.3. Automekanik;
  - 7.4. Teknologjia e riciklimit;
  - 7.5. Teknik i dizajnit grafik.
8. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

### A r s y e t i m

Duke u bazuar në dispozitat e shënuara më lartë, si dhe me qëllim të përkrahjes së Arsimit dhe Aftësisimit Profesional (AAP), duke pas parasysh nevojat e tregut të punës, si dhe në mbështetje të kërkesave të IAAP-ve dhe stimulimit të nxënësve në drejtimet deficitare dhe vajzave në drejtimet teknike, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **Vendimi i dërgohet:**

1. Kabinetit të Ministrit;
2. Sekretarit të Përgjithshëm;
3. Drejtorive Komunale të Arsimit (DKA-ve);
4. Institucioneve të Arsimit dhe Aftësisimit Profesional (IAAP);
5. DAAP;
6. Dep. të financave dhe shërbimeve të përgjithshme;
7. Arkivit të MASHTI

